

## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

### **NDËRMJET**

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**DHE**

**MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE  
INFRASTRUKTURËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËR**

**NDËRTIMIN E LIDHJES HEKURUDHORE  
DURRËS - PRISHTINË**

#### **Preambula**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Republikës së Kosovës në vijim të quajtura "Palët",

Duke marrë parasysh rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh në zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme përgjatë lidhjes hekurudhore Durrës - Prishtinë,

Duke riafirmuar se zhvillimi i lidhjes përgjatë Rrugës 7 (*Route 7* / Durrës – Prishtinë) do të përmirësojë lidhjet e transportit hekurudhor në rajon dhe do të nxisë marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare,

Duke njohur rëndësinë e përpjekjeve të ndërsjella për të mbështetur iniciativat e Investimeve me Bashkimin Evropian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe me sektorin privat për përshpejtimin e zhvillimit të lidhjes multimodale Durrës - Prishtinë,

Palët e këtij Memorandumi Mirëkuptimi kanë rënë dakord të punojnë së bashku për përparim të mëtejshëm dhe për të siguruar një infrastrukturë të transportit hekurudhor rajonal më efikase dhe moderne me cilësi të lartë.

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është të krijojë një kuadër bashkëpunimi midis dy palëve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve në linjën hekurudhore Durrës – Prishtinë. Gjithashtu nëpërmjet tij do të riafirmohet vullneti dhe gatishmëria e palëve për planifikimin afatgjatë të infrastrukturës dhe zhvillimin e koordinuar të lidhjes Durrës – Prishtinë, me fokus përmirësimin e ndërlidhjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

